



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:125283

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05722177

C.nr.1172/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtare Dora Bajrami, me bashkëpunëtoren profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.G.B. me numër personal B.B. me numër personal V.K. me numër personal N.G. me numër personal dhe Z.K. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av.D.Z. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 17,227.40 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., që të gjithë nga Prizreni, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, ti paguaj shumat si në vijim:
 1. Paditëses B.G.B. për periudhën kohore prej datës 01.06.2018 deri më datë 31.12.2022 apo për 54 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 459 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 3,252.40 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 18.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
 2. Paditësit B.B. për periudhën kohore prej datës 01.06.2018 deri më datë 31.12.2022 apo për 54 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 459 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 3,252.40 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 18.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

3. Padiësit V.K. për periudhën kohore prej datës 01.06.2018 deri më datë 31.12.2022 apo për 54 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 459 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 3,252.40 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 18.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
4. Padiësit N.G. për periudhën kohore prej datës 01.06.2018 deri më datë 31.12.2022 apo për 54 muaj (për çdo muaj shumën prej 78.10 euro, në shkallë prej 35 % të pagës bazë - 459 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 4,217.40 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 18.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
5. Padiësit Z.K. për periudhën kohore prej datës 01.06.2018 deri më datë 31.12.2022 apo për 54 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 459 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 3,252.40 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 18.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që padiësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 644.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Padiësit B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.D.Z. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me dt. 18.06.2021, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 17,227.40 euro.

I autorizuari i padiësve në padi ka theksuar, se padiësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë SHM "Lorenç Antoni" në Prizren, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Padiësja B.G.B. është e diplomuar në fakultetin e arteve dhe ka kualifikimin bachelor i pianos, B.B. është i diplomuar në fakultetin e arteve dhe ka kualifikimin profesor i artit muzikor, V.K. është i diplomuar në fakultetin e arteve dhe e ka kualifikimin profesor i artit muzikor, N.G. është i diplomuar në fakultetin e arteve dhe ka kualifikimin master i pedagogjisë së muzikës, dhe padiësi Z.K. është e diplomuar në fakultetin e arteve dhe ka kualifikimin e artit muzikor. Bazuar në kontratën kolektive të arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, padiësit kanë fituar të drejtën e tyre në kompensim në bazë të kualifikimit-licencimit, varësisht nga niveli i shkollimit mund të jetë 19%, 27% apo 35%. Padiësit sipas kontratës së punës dhe

listës së pagave për punën si mësimdhënës realizojnë pagën mujore në vlerë prej 421 euro dhe për kualifikimin e tyre të njëjtit realizojnë shumën në vlerë prej 58.32 euro, e cila nuk përkon me vlerën 19%, 27% dhe 35%. Bazuar në të lartëcekurat, ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore, i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 20.01.2023, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë precizuar dhe saktësuar kërkesëpadinë, pasi që e paditura ka pretenduar se paditësve iu është parashkruar një pjesë e kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi dhe atë, për periudhën nga muaji qershor 2018 deri në muajin dhjetor 2022, apo për 54 muaj. Paditësit B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., kanë kualifikimin fakultet, paga bazë e tyre është në lartësi prej 459 euro, dhe në emër të kualifikimit marrin shumën prej 63.68 euro në muaj, ndërsa diferenca në vlerë prej 60.25 euro në muaj mbetet e pa paguar, andaj ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve t’iu kompensojë shumën prej 3,252.50 euro (llogaritur 60.25×54), ndërsa paditësi N.G. ka kualifikimin master dhe në kuadër të kualifikimit merr shumën prej 82.55 euro në muaj, dhe diferenca në vlerë prej 78.10 euro në muaj mbetet pa paguar, andaj ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditësës t’ia kompensojë shumën prej 4,217.40 euro (llogaritur 78.10×54).

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda 3 viteve, ndërsa në rastin konkret padia është parashtruar me kërkesë për vitin 2017. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësës të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësës është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHM “Lorenc Antoni” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, nga kontrata e punës nr.11 të datës 01.09.2015 e lidhur ndërmjet paditëses Besarta Guri Bobaj dhe të paditurës, rezulton se paditësja është i punësuar tek e paditura si mësimdhënëse, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e arteve, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1009, e datës 24.03.2015, e lëshuar nga Universiteti i Arteve-në Prishtinë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i pianos. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Nga kontrata e punës nr.228/2 të datës 02.09.2019 e lidhur ndërmjet paditësit B.B. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënësi, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e arteve, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1427, e datës 11.11.1981, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Akademia e Arteve, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin profesor i artit muzikor. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Nga kontrata e punës nr.251-52 të datës 01.09.2018 si dhe ajo me nr. 228/5 e datës 02.09.2019, e lidhur ndërmjet paditësit V.K. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënësi, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e arteve, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 3, e datës 25.11.1985, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Akademia e Arteve, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin profesor i artit muzikor. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Nga kontrata e punës nr.89 të datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet paditësit N.G. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënësi, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar në nivelin master, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e arteve, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 367, e datës 29.04.2015, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Arteve, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin master i pedagogjisë së muzikës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit Mr.Dr, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 82.55 euro.

Nga kontrata e punës nr.228/11 të datës 02.09.2019, e lidhur ndërmjet paditësit Z.K. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënësi, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e arteve, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 451, e datës 02.06.1988, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Arteve, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin profesor i artit muzikor. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%*”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar paditësve B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., shumën prej 63.68 euro ndërsa paditësit N.G. shumën prej 82.55 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, ndërsa paditësi N.G. përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve B.G.B., B.B., V.K., N.G. dhe Z.K., për çdo muaj t’ia paguaj diferencën e papaguar dhe atë shumën prej 60.25 euro, për 54 muaj, nga data 01.06.2018 e deri me datë 31.12.2022, në shumën e përgjithshme prej 3,252.50 euro, për secilin paditës, ndërsa paditësit N.G. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 78.10 euro, për 54 muaj, nga data 01.06.2018 e deri me datë 31.12.2022, në shumën e përgjithshme prej 4,217.40 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 18.06.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep

aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Po ashtu, pretendimi se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar gjykata e vlerësoi të pa bazuar për faktin se paditësit kanë bërë precizimin e kërkesëpadisë e sipas këtij precizimi nuk kemi të bëjmë me kërkesë të parashkruar pasi që sipas nenit 87 të Ligjit të punës, “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, e që në rastin konkret paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 18.06.2021, ndërsa kërkesa e tyre ka qenë për periudhën nga data 01.06.2018 deri me datë 30.11.2022, pra nuk kanë kaluar 3 vite andaj edhe një kërkesë e tillë nuk është parashkruar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 644.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 624 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, sepse nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrës të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1172/2021 të datës 22.05.2024

Gjyqtare

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.